URDHËR
Nr. 131, datë 13.2.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E REPUBLIKËS SË ÇEKISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,
nga shteti i Çekisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1	Středočeský	Příbram*
2	Plzeňský	Klatovy*
3	Jihočeský	Strakonice*
4	Plzeňský	Plzeň – jih*
5	Jihomoravský	Hodonín*
6	Jihomoravský	Břeclav*
7	Jihomoravský	Brno-Venkov*
8	Liberecký	Česká Lípa*
9	Středočeský	Mladá Boleslav*
10	Jihomoravský	Znojmo*
11	Moravskoslezský	Opava*
12	Karlovarský	Sokolov*
13	Karlovarský	Hradec Králové*
14	Kraj Vysočina	Jihlava*
15	Pardubický	Ústí nad Orlicí*
16	Ústecký	Teplice*
17	Středočeský	Praha – východ*
18	**Plzeňský**	**Rokycany***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 120, datë 5.2.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Çekisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj